# DËSHMI ARKIVI

**A-473721**

VERSIONI 1

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Ndahet nga jeta fotoreporteri që dokumentoi eksodin e shqiptarëve në ’91 |
| ADRESA | `https://joq-albania.com/artikull/1394452.html` |
| BURIMI | joq-albania.com |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 27 shtator 2026, 12:26:39 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| LEXUAR NGA FAQJA | 27 shtator 2026, 12:14:00 UTC<br>*Portali nuk e deklaron datën në asnjë formë makinë-lexueshme; kjo është ora e shkruar për njeriun, e lexuar nga faqja me metodën **text_date**. Dritarja: 27 shtator 2026, 12:13:00 UTC → 27 shtator 2026, 12:15:00 UTC. Kalon nga një rregull i yni që mund të gabojë, prandaj shfaqet si e lexuar dhe jo si e deklaruar.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `48c02c9d01cfb75a17e39be94cffb1eafeaea12a4635ea849fe5689d48a4df3e` |
| TEKSTI | `6f8da971669c8df07218b9e541895429b31c41319dcd8073681104cf8fd592d0` |
| PAMJA | `51ab177426a1a2d694da1c5a694a2cbdfc9ef1c456100fbac99481bec087505b` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `e422e7d6fdf521b85d652ef69184d27bc20ed10d8bcdc18597f0cb59ac5313a5` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `8943aae4786784478314ed8f36e25f0bd32ee36cc85ad3e80ac7b853175904e3` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/e422e7d6fdf521b85d652ef69184d27bc20ed10d8bcdc18597f0cb59ac5313a5`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

# Ndahet nga jeta fotoreporteri që dokumentoi eksodin e shqiptarëve në ’91

Shkruar nga: S. H | Publikuar më: 27.09.2026, 14:14

Share Share



Fotoreporteri italian Luca Turi është ndarë nga jeta në moshën 82-vjeçare, pas një karriere pesëdekadëshe në dokumentimin e ngjarjeve më të rëndësishme të Barit dhe Pulias. Turi, i cili ka punuar edhe për ANSA-n, la pas një arkiv të pasur fotografik që dëshmon historinë e afërt të rajonit.

Ndër fotografitë më të njohura të tij janë ato të 8 gushtit 1991, kur anija “Vlora” mbërriti në portin e Barit me rreth 20 mijë shqiptarë në bord. Turi fiksoi me aparatin e tij pamjet e mijëra emigrantëve të mbledhur në anije dhe në port, duke dokumentuar një nga momentet më dramatike të eksodit shqiptar drejt Italisë.

Ndarja e tij nga jeta u bë e ditur nga ANSA, ndërsa kryebashkiaku i Barit, Vito Leccese, e cilësoi Turi-n një fotograf të madh dhe dëshmitar autentik të historisë së qytetit. Fotografitë e “Vlorës” mbeten një prej dëshmive më të fuqishme vizuale të eksodit shqiptar të vitit 1991.

**FACT CHECK:** Synimi i JOQ Albania është t’i paraqesë lajmet në mënyrë të saktë dhe të drejtë. Nëse ju shikoni diçka që nuk shkon, jeni të lutur të na e raportoni këtu.

JOQ Sondazh
KLIKO PËR TË VOTUAR

TË NGJASHME



Më të Lexuarat

Aleanca për Media Etike ARTIKULL JOETIK?




Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.